# DËSHMI ARKIVI

**A-439342**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rexhaj: Pas kompromisit të fundit të LVV-së, duhet të përmbyllet konstituimi i Kuvendit |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/rexhaj-pas-kompromisit-te-fundit-te-lvv-se-duhet-te-permbyllet-konstituimi-i-kuvendit/1009305/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 08:30:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 08:29:57 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0f11e53431a355349bb784918872533f24f71f18e6565481ce5ed38111e39819` |
| TEKSTI | `45d86bc368d4cb19139ee4f269174f8c52e16d88bc03eef910b22f60f66356b0` |
| PAMJA | `587023e8df4b98d697b44f97fbfd9aab511f215d7d346edcd448cef2de6e317e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3880d75aefde0eaa72e208d6a1a5f3c792993f641bede4ed274890a01e8c602f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `10ab5b8f79eea0a6c9439c21099c504de5d405b01d4b1e67f07490a5465dacd2` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3880d75aefde0eaa72e208d6a1a5f3c792993f641bede4ed274890a01e8c602f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rexhaj: Pas kompromisit të fundit të LVV-së, duhet të përmbyllet konstituimi i Kuvendit



Arbër Rexhaj, deputet i Lëvizjes Vetëvendosje, ka deklaruar se subjekti i tij politik e ka bërë kompromisin përfundimtar për tejkalimin e bllokadës rreth konstituimit të Kuvendit. Ai u ka kërkuar partive të tjera të paraqesin kandidatët e tyre për nënkryetarë, në mënyrë që të vazhdohet me krijimin e institucioneve.

Duke folur para nisjes së vazhdimit të seancës konstituive, Rexhaj tha se një konstituim i Kuvendit pa marrëveshje politike do ta çonte vendin drejt zgjedhjeve të reja.

Sipas tij, një ditë më parë ishte zhvilluar mbledhja e kryesisë, ndërsa LVV-ja tashmë kishte bërë kompromisin e fundit. Rexhaj theksoi se palët e tjera duhet të vijnë me propozimet për emrat dhe procesi të ecë përpara.

Deputeti i LVV-së u pyet gjithashtu për mundësinë e zhvillimit të një takimi ndërmjet Albin Kurtit, Bedri Hamzës dhe Lumir Abdixhikut, por nuk dha hollësi konkrete nëse një takim i tillë do të mbahej.

Rexhaj mohoi se LVV-ja po punon për ta dërguar vendin në zgjedhje të reja. Ai deklaroi se kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka bërë përpjekje për të vendosur komunikim me partitë opozitare, me qëllim që situata të tejkalohet.

Ai tha se Kurti u dërgon vazhdimisht mesazhe përfaqësuesve të partive dhe se ka tentime për komunikim me PDK-në dhe LDK-në. Sa i përket Aleancës, Rexhaj u shpreh se nuk ishte i sigurt, por besonte se përpjekje të tilla kishte pasur.

Sipas Rexhajt, partitë e tjera kishin mundësi ta zhbllokonin procesin duke ndryshuar emrat e propozuar për nënkryetarë. Ai vlerësoi se Kuvendi mund të ishte konstituuar lehtësisht dy ditë më parë, pasi vendimi ishte në duart e tyre.

Rexhaj shtoi se, nëse bëhet fjalë për një strategji politike që lidhet me konstituimin dhe datën e përfundimit të këtij procesi, palët e tjera e kishin pasur mundësinë ta konstituonin Kuvendin para dy ditësh. Sipas tij, ndryshimi i

të fundit/


Murati: Pengesa nuk lidhej me konstituimin, por me çështjen e…


Milani ende në kërkim të ekuilibrit, Amorimit i dalin përpara katër…


LVV-ja sqaron ndryshimin e qëndrimit për Çitakun dhe Shalën


LIVE: PDK-ja bojkoton vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit


Rimac zgjeron kontrollin mbi Bugatti-n pas marrëveshjes së …


Tri ndeshje sot në Superligën e Kosovës, spikat përballja mes…


Real Madridi gjen një kandidat të mundshëm për të zëvendësuar…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

emrave të propozuar do ta kishte mundësuar konstituimin e Kuvendit para 48 orëve.

Ai e cilësoi si valide marrëveshjen politike me LDK-në, pavarësisht deklarimeve të gjashtë deputetëve të kësaj partie se nuk do të merrnin pjesë në votim.

Rexhaj përsëriti se konstituimi i Kuvendit pa një marrëveshje politike do ta orientonte vendin drejt zgjedhjeve. Megjithatë, sipas tij, tashmë ekziston një marrëveshje politike valide me LDK-në, ndërsa qëndrimi i 6 deputetëve të saj për të mos marrë pjesë dhe për të mos votuar mbetet çështje e tyre.

Në këto rrethana, ai tha se ka bazë për thirrjen e një seance, vazhdimin e konstituimit të Kuvendit dhe themelimin e institucioneve.

Shtuar më 13.09.2026 10:29

Tags: Arbër Rexhaj , Konstituohet , LVV



Murati: Pengesa nuk lidhej me konstituimin, por me çështjen e presidentit



LVV-ja sqaron ndryshimin e qëndrimit për Çitakun dhe Shalën



LIVE: PDK-ja bojkoton vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit



LIVE: Kuvendi vazhdon sot seancën, në fokus zgjedhja e nënkryetarëve



Hoxhaj përshëndet 100 mijë shqiptarët që marshuan me UÇK-në në…



Halilaj për bllokimin e Kuvendit: Çështjet e Thaçit, Veselit dhe UÇK-së nuk…



Sadiku akuzon LVV-në për bllokim institucional: Po synojnë zgjedhjet e 27…




Ramadani: LVV-ja po e mban peng konstituimin e Kuvendit për të kalkuluar…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko

**Kryesore**

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.